Përshëndetje,

Në përgjige të kërkesës suaj për informacion ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Referuar pyetjeve tuaja vlerësojmë të informojmë se zotërimi i statusit të nëpunësit civil, në vetvete, nuk përbën pengesë për pjesëmarrjen në procedurën për plotësimin e një pozicioni të kategorisë së mesme drejtuese.

Neni 26, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, parashikon se mund të aplikojnë për procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë:

a) nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele;
b) *nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse*, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Pika 4, e nenit 26, të ligjit të sipërcituar parashikon se përjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira.

Në kuptim të sa më sipër, nëpunësi civil mund të marrë pjesë në procedurat e parashikuara nga ligji për nëpunësin civil, nëse plotëson kushtet dhe kërkesat përkatëse dhe nuk mund të trajtohet njësoj me një kandidat që vjen nga jashtë sistemit të shërbimit civil.

Pikërisht neni 26, i ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, bën dallimin midis këtyre kategorive. Për nëpunësit civilë që konkurrojnë nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë, kërkohet që ata të jenë në kushtet e përcaktuara nga ligji, përfshirë kategorinë e pozicionit nga i cili vijnë, plotësimin e kushteve dhe kërkesave të posaçme për pozicionin. Ndërkohë, kur procedura, në kushtet e parashikuara nga pika 4, e nenit 26, hapet edhe për kandidatë të tjerë, këta kandidatë nuk hyjnë në procedurë në cilësinë e nëpunësve civilë dhe, për rrjedhojë për t'a zbatohen kushtet dhe kërkesat e përcaktuara për kandidatët e jashtëm dhe për procedurën konkrete të konkurrimit. Pra, hapja e procedurës edhe për kandidatë nga jashtë nuk e ndryshon natyrën e procedurës që zbatohet për nëpunësin civil.

Legjislacioni për shërbimin civil nuk vendos një ndalim të përgjithshëm për nëpunësin civil që të konkurrojë për një pozicion më të lartë. Përkundrazi, ai parashikon mekanizmin e ngritjes në detyrë si një nga mënyrat e zhvillimit të karrierës së nëpunësit civil. Vetë qëllimi i këtij mekanizmi është që kalimi në një kategori më të lartë të bëhet nëpërmjet një procedure të bazuar në meritë dhe në plotësimin e kritereve të përcaktuara paraprakisht.

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 28, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al."

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,